

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"FastExchange" SHPK**

Sot me daten 10.12.2024 ,themeluesi:

Endri Kadare i biri i Ali-ut ,i datelindjes 05.04.1986, lindur ne Vlore,Shqiperi dhe banues ne Vlore,Shqiperi me Adrese,Lgj Lirim,Rruga Rakip Malile,Vlore , identifikuar me Nr. ID I60405117F.

Ne perputhje me Ligjin nr.9901 Date 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 date 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Ka vendosur te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar " **FastExchange** " Shpk.

**Neni 1.**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

Shoqeria do te quhet " **FastExchange** " SHPK

**Neni 2**

**SELIA E SHOOERISE**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: **Bashkia Vlore, Qyteti:Vlore, Lagja Pavarsia ,Rruga Kosova Pallati Nr. 1, Kati 1.ZK9401**. Shoqeria mund te hape filiale te tjera ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe ne te gjitha shtetet jashte territorit te Republikës së Shqipërisë.

**Neni 3**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

Veprimtari e agjentit per transferte parash ne emer dhe per llogari te nje subjekti finciar jobanke.Veprimtari e agjentit per sherbimet e pagesave ne emer dhe per llogari te nje subjekti finciar jobanke.Veprimtari e agjentit komisioner.Veprimtari e kembimit valuator. Agjent Siguracionesh.Shitje bileta udhetimi. Agjenci Udhetimesh.Paketa Turistike.



#### **Neni 4**

### **KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE**

Kapitali themeltar i shoqerise do jete 2.500.000 ( Dy milion e peseqind mije )Leke.Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e plote te Endri Kadare me vlere te pergjithshme prej 2.500.000 leke.Keto kuota i perkasin ortakut te vetem si me poshte:

1. Endri Kadare ID Nr. I60405117F zoterues i 1(kuote) me vlere te pergjithshme 2.500.000 leke perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakut.

#### **Neni 5**

### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar.

#### **Neni 6**

### **ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

Administrator i shoqerise do te jete Z. Endri Kadare ID Nr. I60405117F, e cili emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte rizgjedhje.Nje Administrator tjeter mund te emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Administratori ka te gjithë kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te trete ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep ortakeve.

#### **Neni 7**

### **VENDIME TE ASAMBLESE SE PERGJITESHME**

Asambleja e pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres.

Vendimet e asamblese se pergjithshme merren bazuar ne perqindjen e kapitalit e zoteruar prej secilit ortak, konformn pikes 1 neni 86 i ligjit 9901 dt.14.04.2008 "Per shoqerite Tregtare",

Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjitheshrne regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Duhet regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.



Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria proven se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

### **Neni 8**

#### **NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi do te shperndahet midis ortakeve respektivisht sipas kuotave te kapitalit themeltar te investuar te shprehura ne nenin 4 te ketij akti. Fitimi i destinuar per tu shperndare perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven ligjore dhe te tjera rezerva statutore , si dhe duke i shtuar apo zbritur respektivisht humbjet e mbartura nga vitet e meparshme.

### **Neni 9**

#### **LIKUIDIMI**

Shoqeria eshte ne likuidim e siper qe ne momentin e prishjes se saj, operacion i cili do te kryhet sipas kerkesave te parashikuara ne legjislacionin tregtar shqiptar.

### **Neni 10**

#### **MOSMARREVESHJET**

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, Themeluesi do ti drejtohet Gjykates se Rrethit per zgjidhje.

#### **SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“FastExchange” Shpk**

**Ortak**

**Endri Kadare**



